

OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 21.09.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ruajtja e godinës kryesore DRSSH-Korçë me një vend roje dhe sistem alarmi, ruajtja e Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore Korçë me 1 vend roje dhe sistem alarmi, ruajtja e ALSSH - Pogradec me 1 vend roje dhe sistem alarmi, ruajtja e ALSSH - Bilisht me 1 vend roje dhe sistem alarmi, ruajtja e ALSSH Ersekë me sistem alarmi, si dhe ruajtja e ALSSH Maliq me sistem alarmi”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

98341140-8 Shërbime sigurimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,833,013 (gjashtë milion e tetëqind e tridhjetë e tre mijë e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohet në nenin 82 dhe 83 të LLP-së Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe nenet 14/1, 14/2, 25, 26 të V.K.M-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

a. .Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje të nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", dhe të nenit 26 të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *"I Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos në mbështetje të nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: *Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.* Pika 2 Neni 83: *Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe mbështetje të nenin 30 të V.K.M-së nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.*

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik të jete i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 2, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 datë 24.12.2021 "Rekomandim hartimin e kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime". Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që Autoritetet Kontraktore të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së

operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoritetet Kontraktore në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 55, pika 4, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për Autoritetet Kontraktore, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licensë të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të “Shërbimit të ruajtjes dhe/ose sigurisë fizike”, nënkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”, lëshuar nga QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.2 është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, i ndryshuar, neni 7, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë e titullarit dhe drejtuesit teknik të subjektit, e vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së ruajtjes dhe të sigurisë fizike për nënkategorinë 1.3.A.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.3 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, i ndryshuar, neni 9, Udhëzimin nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Individual në emër të shoqërisë për përdorimin e frekuencave për radiokomunikim dhe alarm të lëshuar nga AKEP në zbatim të ligjit Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, me zonë mbulimi në Qarkun e Korçë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.4 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe ligjit Nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar, Kreu VII, pika 4 Rekomandimit të përbashkët të APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017. Zona e mbulimit është kërkuar në Qarkun e Elbasanit, duke marrë në konsideratë se objektet për të cilat do të ofrohet shërbimi objekt prokurimi janë brenda këtij qarku.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë Qendër Kontrolli në Qarkun Korçë. Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin Akt Miratim të lëshuar nga DVP Korçë, sipas Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.5 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar, Kreu VII, Rekomandimit të perbashket të APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentin e Performacës mbi mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të operatorit ekonomik për vitin 2025.

Për këtë duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë, ku jepet informacioni i mëposhtem:

- Numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar, jo më pak se 5 punonjes të certifikuar sipas ligjit 75/2014 ” Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike”, i ndryshuar.
- Numrin e punonjësve të grupit të gatshëm dhe të operatorëve të qendrës së kontrollit sipas Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar:
- vlefshmerinë e certifikatave
- datën e certifikimit (datën e lëshimit)
- afatin e vlefshmerisë së kesaj certifikate
- Nuk duhet të ketë masa administrative për Subjektin, Titullar Subjekti dhe Drejtues Teknik sipas përcakimeve të ligjit 75\2014 ”Per sherbimin Privat te Sigurise Fizike”, i ndryshuar si dhe udhëzimit të ministrit të brendshëm nr. 150, datë 16.8.2024“Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.6 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar, Kreu VI, Rekomandimit të perbashket të APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë personelin e nevojshëm dhe vërtetimet e nevojshme profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Eshtë kërkuar numri i disponimit të pakten 5 punonjesve duke patur parasysh që shërbimi do të kryhet duke monitoruar kamerat dhe sistemet e alarmit nga salla e kontrollit duke patur parasysh punonjesit e grupit të gatshëm dhe operatorët e salles së kontrollit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, të paktën 4 punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave nga të cilët, si më poshtë:

- Përgjegjës shërbimi 1 punonjës të kategorisë 1.3.A
- Operator salle kontrolli 1 punonjës të kategorisë 1.3.A,
- 2 (dy) punonjës të kategorisë 1.3.A, grup të gatshëm sipas Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajnimit privat të punonjësve të shërbimit”, i ndryshuar:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikatat e punonjësve të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Korçë për nënkategorinë 1.3A.
- Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, germa b/c,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024, Rekomandimit të perbashket të APP dhe KPP nr.15166 prot date 20.12.2017.

Numri i kerkuar i punonjesve eshe bere referuar Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024, Kreu VII, germa ç, pika 3. *Shërbimi në Qendrën e Menaxhimit të Shërbimeve kryhet nga një punonjës shërbimi (operator) të trajnuar, pa ndërprerje, gjatë 24 orëve, me tre turne.*

4. *Për verifikimin e sinjaleve të alarmit, SHPSF-të organizojnë shërbim me punonjës verifikues të pajisur me armatim (jo më pak se dy punonjës shërbimi në turn), me mjete speciale për ndërhyrje në raste emergjence, si dhe automjete për lëvizjen e tyre., si dhe referuar rekomandimit të APP Tirane dhe KPP Tirane eshte përcaktuar se per sherbim 24 ore, pa nderprerje (nga e Hena, ne te Diele), numri i rojeve per nje vendroje duhet te llogaritet me koeficientin e zevendesimit 1,66 punonjes per turn. 1,66 punonjes x 3 turne = 4.98 punonjes sherbimi roje.*

Sa më sipër, bazuar në specifikimet teknike, ku shërbimi me roje kërkohet për tre turne, ky është numri minimal i punonjesve të kerkuar pasi cdo SHPSF e ka detyrim ligjor të ketë 1 përgjegjës, 1 operator dhe 2 persona Grup i gatshëm.

2.3.8 Ofertuesi duhet të disponojë duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet, për ndërhyrje në raste emergjente, në pronësi të shoqërisë apo të marre me qera, si më poshtë:

- 2 (dy) automjete:
- 1 (një) Motorr

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Në rastin kur automjeti është në pronësi të ofertuesit të paraqitet: Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore.
- Në rastin kur automjeti është marrë me qera, Leja e qarkullimit të mjetit, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore duhet të shoqërohen edhe me Kontratën noteriale të marrjes me qera, ku të jetë përcaktuar afati dhe qëllimi i marrjes me qera.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Udhëzimit nr. 150, datë 16.8.2024, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

AK e gjykon te nevojshme qe per realizimin e shërbimit sipas specifikimeve teknike kërkohet që operatori ekonomik të disponojë të paktën 2 automjete dhe 1 Motorr për raste emergjente.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të vertetojë se ka në stafin e tij të paktën:

- a. 1 (një) inxhinier elektronik/teknologji informacioni/, inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike.

Për të provuar kriterin e mësipërm operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- diplomën përkatëse.
- kontratë pune të vlefshme

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme 2.3.9 është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma b/c,) të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te disponoje staf te nevojshem duke patur parasysh numrin e kamerave dhe sistemeve te alarmit qe do vendosen/mirembahen si dhe shtrirjen ne objektet ku do te kryhet shërbimi. Prania e inxhinierit është i nevojshëm për mirembajtjen e sistemeve

elektronike te sigurse si kamera, system alarmi, sesnore dhe sisteme sinjalizimi. Duke qene se keto sisteme kerkojne njohuri teknike per programim dhe funksionim ne rrjet, prania e nje inxhinieri elektronik/teknologji informacioni/, inxhinieri telekomunikacioni/informatikë ekonomike/informatike/inxhinieri informatike garanton funksionim korrekt te sistemeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Kamera me instalim te brendeshme dhe të jashtme, 2.0Mpx, IR

Sensori:	1/2.8” inch, 2.0 Megapixel CMOS (color) ekuivalente
Kompresimi Video:	H.265, H.264
Rezolucioni:	minimumi 1920x1080,
Imazhe për sekond:	te pakte 25 fps, për regjistrim në full HD
Multistream:	Po, deri në 3 stream ose me mire
Reduktimi i zhurmave:	te kete mekanizem per reduktimin e zhurmave
Balancim drite:	BLC, HLC, ekuivalente
Lloji i Lentës:	Motorized/Automatike
Lentja:	2.8 – 12mm, ose me gjere
Këndi i shikimit:	100° – 35° Horizontal, 50° – 20° Vertikal ose me mire IR-cut Filter. Po,
Infrared:	te kete filtra ir etj
Stabilizim Imashi	Po,
Minimuni i ndricimit:	te pershtaten me ambientet e jashteme dhe te brendeshme
Kontrolli Bit Rate:	te mundesohet
Komunikimi:	RJ-45, 100/1000Mbps Base-T Ethernet Interface
panel kontrolli	Akses, pamje live, konfigurim nga rrjeti
Suporton:	Microsoft Edge, Internet Explorer, Mozilla, Chrome
Siguria:	Mbrojtje me fjalëkalim, suporton deri në 10 përdorues
Suporton Analitic:	Po,
Standarte:	IP67 për mjedisin, IK10 për fortesinë (vandalproof).
Ushqimi:	PoE (802.3at), 12V DC
Konsumi i fuqisë:	më pak se 13W

Temperatura e punës: te pershtaten me temperaturat e ambjenteve,

Shenim: Te dhenat e kamerave jane te pershtatura sipas nevojave te institucionit, kurse te dhenat e NVR jane mare nga specifikimet teknike te AKSH-it.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Tipi:	NVR 4 kanale, me switch të intergruar me 4 porta PoE
Nr. Kanaleve:	Min. 4
Memorie Storage:	Min. 8 TB efektive storage me HDD të certifikuar për sisteme vëzhgimi.
Switch PoE+ të intergruar;	Min. 4 x 10/100 (802.3af ose 802.3at) Min. 1 x 10/100 (RJ-45)
Kompresimi video;	H.265 ose H.264
Faktori i formës “Form Factor”:	1U, i pajisur me aksesore për montim në rack
Certifikimi i Produktit /Direktiva:	min. CE
Porta USB:	Min. 2 porta USB
Temperaturat e operimit:	-10°C ~ + 40°C

Të dhënat dhe specifikimet teknike të kamerave janë përshtatur në përputhje me nevojat dhe kërkesat funksionale të institucionit, duke synuar një raport të balancuar ndërmjet performancës, funksionalitetit dhe kostos. Parametrat e përcaktuar përfaqësojnë karakteristika mesatare dhe të arsyeshme për këtë kategori pajisjesh, të cilat janë të mjaftueshme për përmbushjen e qëllimit të përdorimit dhe garantimin e një niveli të përshtatshëm monitorimi dhe sigurie. Përzgjedhja e këtyre parametrave nuk është bazuar në kërkesa të veçanta apo specifikime të pazakonta, por në standarde dhe karakteristika teknike që përdoren gjerësisht në pajisjet e ngjashme të disponueshme në treg. Për më tepër, këto specifikime mund të gjenden lehtësisht në treg nga prodhues dhe furnitorë të ndryshëm, duke krijuar mundësi për konkurrencë të gjerë ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke shmangur orientimin drejt një produkti, marke apo prodhuesi specifik. Në këtë mënyrë, parametrat e përcaktuar synojnë të sigurojnë një zgjidhje funksionale dhe të përshtatshme për institucionin, pa vendosur kërkesa të panevojshme ose kufizuese që mund të ndikojnë në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Ndërsa, sa i përket specifikimeve teknike të pajisjeve NVR, parametrat e përcaktuar janë marrë në referencë nga specifikimet teknike të AKSHI-t, duke u bazuar në kërkesat dhe standardet teknike të aplikuara për këtë kategori pajisjesh.

Specifikimet teknike, përlogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike të hartuara nga AK janë pjesë e pandashme e DST.

Në dokumentacionin e hartuar nga grupi i punës, rezulton se:

Analiza e nevojës

Autoriteti kontraktor ka si qëllim garantimin e sigurisë fizike të objekteve, personelit dhe dokumentacionit, përmes:

- ruajtjes me roje fizike,
- Shërbim me sistem vëzhgimi me kamera i ambienteve të Drejtorisë Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Korçë.

Sistem alarmi. Ky shërbim është thelbësor, i vazhdueshëm dhe kërkon funksionim 24/7, si dhe reagim të menjëhershëm ndaj çdo situatë emergjente.